

# Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2024

**Tiranë, më 30 Prill 2025:** Ky publikim paraqet statistika mbi veprat dhe procedimet penale të regjistruara dhe statistika mbi personat e përfshirë në sistemin e drejtësisë penale, si të dyshuar, të pandehur dhe persona të burgosur.


- Në vitin 2024, janë evidentuar gjithsej 32.653 vepra penale, 3,5 % më pak, krahasuar me vitin 2023;
- Numri i autorëve të dyshuar për vepra penale në vitin 2024 arriti në 40.057, me një rritje prej 1,4 %, krahasuar me vitin paraardhës:
  - 93,7 % janë meshkuj, ndërsa grupmosha më e përfaqësuar është ajo 30-44 vjeç, 36,0 %.
- Numri i autorëve pa përsëritje është 33.453, 0,1 % më pak, krahasuar me një vit më parë;
- Në vitin 2024, janë regjistruar 17.761 persona të dëmtuar, 4,3 % më shumë, krahasuar me vitin 2023.
  - 37,9 % e tyre janë të dëmtuar për krime kundër personit, ndërsa femrat përbëjnë 38,8 % të kësaj kategorie, kryesisht në krime seksuale, krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, si edhe në krime kundër moralit dhe dinjitetit.
- Numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2024, është 24.912, me një rritje prej 3,4 %;
- Nga 25.272 procedime penale të përfunduara, 36,6 % e tyre janë pushuar, 26,8 % janë pezulluar dhe 36,6 % janë dërguar për gjykim në gjykatë;
- Në vitin 2024, janë regjistruar 13.167 persona të pandehur, 5,7 % më pak, krahasuar me një vit më parë.
  - Meshkujt përbëjnë 94,6 % të numrit gjithsej të të pandehurve, pothuajse e njëjta përqindje përgjatë pesë viteve të fundit.
- Numri i të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale është 4.491, 13,1 % më pak, krahasuar me vitin 2023.
  - Meshkujt përbëjnë 98,3 % të numrit gjithsej të të burgosurve.

## Vepra penale

Veprat penale: krime kibernetike, përndjekje, vrasje me dashje, vjedhje duke shpërdoruar detyrën, dhuna në familje, pastrim i produkteve të veprës penale, krime seksuale, krime me dashje kundër shëndetit dhe shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor janë rritur krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesa tjetër e veprave penale ka pësuar rënie.

**Për publikim: 30 Prill 2025**

**Fig. 1 Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2024 - 2023**




**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT.

### Autorë të veprave penale

Numri i autorëve sipas veprave penale përfshin numrin e personave të dyshuar të cilët mund të jenë të pranishëm në më shumë se një vepër penale dhe autori numërohet në të gjitha veprat ku është i dyshuar.

Në vitin 2024, 36,0 % e autorëve janë të grupmoshës 30-44 vjeç, 24,8 % të grupmoshës 18-29 vjeç dhe 22,8 % i përkasin grupmoshës 45-59 vjeç.

**Fig. 2 Përqindja e autorëve për vepër penale sipas grupmoshës, 2024**




**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT.

### Të pandehur

Numri i të pandehurve për veprat penale: kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror, dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit, pastrim i produkteve të veprës penale, vrasje me dashje, krime me dashje kundër shëndetit, vrasje të mbetura në tentativë, vjedhje dhe trafikimi i armëve është ulur, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa për pjesën tjetër të veprave ka pësuar rritje.

**Fig. 3 Ndryshimi në përqindje i të pandehurve, 2024-2023**




Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, llogaritjet INSTAT.

### Të burgosur

Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, grupmosha 21-29 vjeç ka numrin më të lartë të të burgosurve. Personat nën 20 vjeç dhe mbi 60 vjeç kanë numrin më të ulët të të burgosurve.

**Fig. 4 Të burgosur sipas grupmoshës, në numër**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, llogaritjet INSTAT.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/>

# Metodologjia

*Burimi i të dhënave:* Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet evidencës vjetore të detajuar sipas neneve të Kodit Penal, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të dhënat mbi statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.

## Koncepte:

### 1. Vepra penale

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

### 2. Autorë

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

### 3. Persona të dëmtuar

Të dëmtuarit e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti.

### 4. Procedime penale

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara, pushuara, pezulluara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim.

Procedime të regjistruara janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin korrent. Procedime të pushuara janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Procedime të pezulluara janë vendimmarrjet e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një vepre penale.

## 5. Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar. Për qëllime statistikore, në totalin e të pandehurve janë shtuar të dhëna edhe për personat nën hetim.

## 6. Të burgosur

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në dhjetor të çdo viti. Të dënuar me burg i referohet personave që ndodhen në burgje, të cilët kanë marrë dënimin përfundimtar me burgim. Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

### Përkufizime

**Vrasje me dashje:** Vepër e kundraligjshme, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përfshihen veprat penale si: Neni 76 Vrasje me dashje, Neni 77 Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 Vrasje me paramendim, Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje, Neni 79 Vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a Vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, Neni 81 Vrasje e foshnjës.

**Krime seksuale:** Përfshihen nenet 100-108/a të Kodit Penal.

**Vjedhje me dhunë:** Përfshihet neni 139 i Kodit Penal.

**Krime me dashje kundër shëndetit:** Përfshihen nenet 86-90 të Kodit Penal.

**Mashtrime:** Përfshihen nenet 143-149/b të Kodit Penal.

**Fallsifikim monedhash:** Përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

**Krime në fushën e drogës:** Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

**Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor:** Përfshihen veprat penale si: Neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi, Neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.

**Trafikimi i armëve:** Përfshihen nenet 278-280 të Kodit Penal.

**Krimi kibernetik:** Përdorimi i një kompjuteri si instrument për qëllime të mëtejshme të paligjshme. Përshihen veprat penale si: 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik, 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik, 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik, 186/a Falsifikimi kompjuterik, 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterike, 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike, 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike, 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike, 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve.

**Pastrim i produkteve të veprës penale:** Përfshihen nenet 287 Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, 287/a Çelja e llogarive anonime, 287/b Pëvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale.

**Përndjekja:** Përfshihet neni 121/a i Kodit Penal.

**Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror:** Përfshihet neni 297 i Kodit Penal.

**Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit:** Përfshihet neni 298 i Kodit Penal.